

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dita e verdiktit për Thaçin, Veselin, Selimin dh - Syri Lajmi i fundit
ADRESA	https://www.syri.net/kosova/916938/dita-e-verdiktit-per-thacin-veselin-selimin-dhe-krasn-iqin-walker-procesi-ne-hage-eshte-me-shume-politik-sesa-drejtesi/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 06:58:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 06:48:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	92289c611239d4d486e513e092d34e8e1975f68e6acde70e03f58bb297a5292f
TEKSTI	ee44f04a88eb6a4dd6e433d6d39928c6656e962d715273eef60e88abe2b2f566
PAMJA	591da8321b6e6101a667ef141a3050ea9a3483d25aaa6bb88437148852acefe1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b923bc498a64d3ea5a6e43e266813ceb6591b0de6a533c567c837993950d9bf6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	41c8867184070196f446ef02a676766cc2aca397aa3ee03de1cf45e9c1c94b04
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b923bc498a64d3ea5a6e43e266813ceb6591b0de6a533c567c837993950d9bf6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ILIR KALEMAJ**
Dokrra hini dhe bota në tranzicion**ENVER BYTYÇI**
Edi Rama edhe në varr nuk ndahet nga Aleksandër Vuçiq!

Dita e verdiktit për Thaçin, Veselin, Selimin dhe Krasniqin/ Walker: Procesi në Hagë është më shumë politik sesa drejtësi

08:48, 16/09/2026

Ish-ambasadori, William Walker, ka kritikuar procesin gjyqësor në Dhomat e Specializuara në Hagë, duke e cilësuar atë si një proces më shumë politik sesa të drejtësisë.

Në një intervistë për RTK, Walker ka thënë se është plotësisht i bindur se ajo që ka ndodhur gjatë gati gjashtë viteve në Hagë ka qenë, sipas tij, "një përqeshje e kërimit të drejtësisë".

Walker ka kritikuar edhe raportin e ish-senatorit zviceran Dick Marty, duke thënë se ka dyshime serioze për saktësinë e tij.

"Vazhdoj të besoj që ky ka qenë keqtrajtim ose keqpërdorim i drejtësisë që nga fillimi", ka deklaruar Walker.

Sipas tij, krijimi i këtij procesi ka qenë i ndikuar nga një qasje politike e institucioneve ndërkombëtare për të krijuar një lloj ekuivalentimi mes krimeve të kryera nga regjimi i Slobodan Millosheviqit dhe veprimeve të pjesëtarëve të UÇK-së.

Walker ka kundërshtuar gjithashtu pretendimet për një zinxhir të centralizuar komandues të UÇK-së, duke thënë se komandantët e zonave kishin një shkallë të konsiderueshme autonomie.

"UÇK-ja nuk ka qenë ushtri shtetërore e natyrshme. Ka pasur lidhje shumë të lirshme midis komandantëve të zonave", ka thënë ai.

Duke folur për përvojën e tij gjatë luftës, Walker ka treguar se kishte vizituar kampet e refugjatëve në Maqedoni dhe Shqipëri dhe kishte dëgjuar dëshmi nga familje të prekura nga vrasjet, dhuna dhe shkatërrimi gjatë luftës.

Ai ka thënë se nuk është befasuar që pas përfundimit të luftës ka pasur raste hakmarrjeje, por ka kundërshtuar që këto veprime të lidhen drejtpërdrejt me një urdhër nga udhëheqësia e UÇK-së.

Walker ka kritikuar edhe kohëzgjatjen e procesit dhe paraburgimit të ish-krerëve të UÇK-së. "Pesë vjet me radhë për të vërtetuar një akuzë të tillë thjesht nuk arrij ta kuptoj se çfarë ka marrë kaq shumë kohë", është shprehur ai.

Ish-ambasadori ka thënë se është "gati 100 për qind" i bindur se pas këtij procesi ka pasur një vendim politik.

më të lexuarat

PDK dërgon në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit

Kurti thirrje liderëve politikë: Ta zgjidhim çështjen e presidentit

Ndërron jetë Flora Brovina, nesër do të dëshmonte për Masakrën e Dubravës

Ambasada amerikane në Kosovë ngrre alarm për 16 shtatorin: Shmangni lëvizjet afër demonstratave

Shkëlqejnë yjet e Kosovës në Itali, Rrahmani dhe Zhegrova në formacionin e javës në Serie A

Kosova pret verdiktin! 16 shtatori në sytë e kosovarëve nga Buroja në Podujevë

Vazhdimi i seancës konstituive sot nga ora 10:00, ky është rendi i ditës

"E gjithë këtë unë thjesht e shoh si proces shumë më politik se sa i drejtësisë. E këtë e kam gjykuar që prej fillimit", ka deklaruar Walker.

Ai ka shtuar se, sipas tij, nuk mund të ketë barazim mes palëve në luftën e Kosovës, duke theksuar se pjesa dërrmuese e dhunës ishte ndërmarrë nga pushteti i Beogradit.

Walker ka folur edhe për pritjet e tij lidhur me vendimin që pritet të merret më 16 shtator, duke shprehur bindjen se drejtësia duhet të triumfojë.

© SYRI.net

Lexo edhe:



FOTO/ Shqiptarët në Hagë e Kosovë, presin në sheshe verdiktin! Djali i Thaçit dhe gruaja e Selimit hyjnë në Gjykatë



Sa i kushtoi Kosovës mbrojtja e të akuzuarve në Hagë?



Hagë/ Dita e verdiktit për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Thaçin dhe të tjerët

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

TË NGJASHME



Kurti rëmëron Jeton Zulfajn Kryenegociator të Kosovës me BE-në



NATO rikonfirmon angazhimin e palëkundur për sigurinë në Kosovë



Kurti emëron 27 zëvendësministra, këta janë emrat



Ora e parë në shkollat e Prishtinës nesër do t'i kushtohet UÇK-së dhe historisë së luftës



Gjyqi ndaj ish krerëve të UÇK-së/ Ish ambasadori kroat: Vendimi i Hagës duhet të pranohet edhe pse mund të jetë e dhimbshme



Edhe Franca u bën thirrje shtetasve të saj në Kosovë: Tregoni vigjilencë, qëndroni larg tubimeve

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net